VENDIM
Nr. 137, datë 19.7.2019

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 7, DATË 21.12.2018, "RREGULLORE PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE TË GJYKATAVE"

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 83, 89 dhe 92, të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; nenin 26, të ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; si dhe nenin 11, të Kodit të Procedurave Administrative, me propozim të Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Pas pikës 1, të nenit 7, të shtohet pikat 2, me përmbajtje si më poshtë:

"2. Kur asnjë prej gjyqtarëve në detyrë nuk plotëson kriteret për t'u zgjedhur zëvendëskryetar apo zgjedhja e tij nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës është objektivisht e pamundur, konsiderohet i zgjedhur si zëvendëskryetar, gjyqtari me përvojën profesionale më të gjatë.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR
KRYETARE
Naureda Llagami